REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Dt,23.11.2022

NJOFTIM

Për përzgjedhjen e operatorit në linjën rrethqytetëse

të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Prrenjas

Bazuar në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, neni 11; urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas nr.484 , dt.13.09.2022, "Për përzgjedhjen e subjektit që do të licencohet në linjen per sherbime te rregullta te specializuara per transportin e nxenesve dhe mesuesve ne Bashkine Prrenjas ":

Bashkia Prrenjas njofton zhvillimin e konkursit për përzgjedhjen e operatorit në linjen per sherbime te rregullta te specializuara per transportin e nxenesve dhe mesuesve si më poshtë:

1	**Prrenjas - Rashtan**

Subjekti fizik ose juridik duhet të disponojë automjet të përshtatshm për kryerjen e transportit të nxënësve dhe mësuesve dhe duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Prrenjas dokumentacionin për pjesëmarrjen në konkurs në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, dt. 18.11.2016, të ndryshuar, si më poshtë:

1. Kërkesa.
2. Formulari i autodeklarimit (për drejtuesin).
3. Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin).
4. Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin).
5. Dokumentacioni i kredibilitetit bankar.

6. Çertifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B.

7. Leja e qarkullimit

8. Çertifikata e kontrollit teknik

9 Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve

10. Çertifikata e kalibrimit të tahografit

11. Kontrata për sigurimin e automjetit

12.Kontrata për sigurimin e pasagjerëve

13. Leja e drejtimit.

14. Çertifikata e Aftësimit Profesional.

15. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Liçencave , mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në periudhën e mëparshme).

Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Bashkisë Prrenjas, deri në datën 09.12.2022 .

Kriteret për klasifikimin e subjekteve, në rast se ka më shumë se një aplikant për linjën përkatëse, do të jenë sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Prrenjas VKB nr.51, dt.28.06.2022 Klasifikimi bazohet në :

1. Vitin e prodhimit të automjetit.

2. Numrin e viteve që subjekti mund të ketë ushtruar veprimtarinë në transportin e udhëtarëve me autobusë.

Për informacion më të detajuar subjektet e interesuara mund të drejtohen pranë Bashkisë Prrenjas